

REPUBLIKA E KOSOVES  
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVA  
KOMUNA E GJILANIT  
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

**ZYRA E KRYETARIT**  
**KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI**

Në bazë të nenit 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale (LVL-) nr. 03/L-040 dhe nenit 78 paragrafi 1 të Statutit të Komunës 01. nr. 016-126211 të dt. 06.11.2014 me ndryshimet dhe plotësimet në Statut 01. nr. 016-28448 të dt. 22.03.2018, Kryetari i Komunës së Gjiçanit merr këtë:

**V E N D I M**

për

**mbështetje financiare për botimin e monografisë “Mësimdhënësit dhe të burgosurit politik të Përlepticës”**

1. Me këtë vendim lejohet pagesa e mjeteve financiare prej **900** (nëntëqind euro) për botimin e monografisë “Mësimdhënësit dhe të burgosurit politik të Përlepticës” me autor Agim Sylejmani dhe Nuhi Nuhiu.
2. Pagesa e mjeteve financiare sipas nenit 1 të këtij vendimi bëhet nga Kodi Buxhetor-Subvencione i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
3. Bartja e mjeteve financiare bëhet në emër të Nuhi Nuhiut në llogarinë bankare me nr. **[REDACTED]**
4. Pjesë e këtij vendimi është Marrëveshja për subvencionim.
5. Ky vendim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit të këtij vendimi.


**Vendimi i dorëzohet:**

- Autorëve
- DBF dhe
- Arkivit.

**Kryetari i Komunës**

**Alban Hyseni**





**KOMUNA E GJILANIT**  
**OPŠTINA GNJILANE**  
**MUNICIPALITY OF GJILAN**  
**GILAN BELEDIYESI**

---

## **MARRËVESHJE PËR SUBVENCIONIM**

**ndërmjet**

**Komunës së Gjilanit, si autoritet publik**

**Dhe**

**Nuhi Nuhiu nga Gjilani, përfitues**

**Gjilan, 2023**

## **Neni 1**

### **Qëllimi i marrëveshjes**

Qëllimi i kësaj marrëveshje është mbështetja financiare për botimin e monografisë “Mësimdhënësit dhe të burgosurit politik të Përlepticës” me autor Agim Sylejmani dhe Nuhi Nuhiu, sipas procedurës së përcaktuar me Rregulloren 01. nr. 016-126422 të dt. 29.12.2016 e ndryshuar dhe plotësuar me rregulloren nr. 2/208,01 nr. 016-28468 të dt. 22.03.2018 për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve (neni 13 dhe neni 22 paragrafi 1.7)

## **Neni 2**

### **Vlera e Subvencionimit**

1. Vlera e subvencionimit është shuma prej 900 € (nëntëqind euro) dhe ndahet nga Kodi Buxhetor- Subvencione i Zyrës së Kryetarit të Komunës.
2. Kjo është shuma e vetme dhe përfundimtare që paguhet nga Komuna e Gjilanit për përfituesin.

## **Neni 3**

### **Obligimet e palëve**

1. **Obligimet e përfituesit të subvencionit janë :**
  - 1.1.Mjetet e marra, përfituesi do t'i shfrytëzoj vetëm për qëllimet e paraqitura në projekt.
  - 1.2.Përfituesi duhet të raportoj tek Komuna e Gjilanit brenda 30 ditëve, pas afatit për përfundimin e marrëveshjes.
2. Përfituesi duhet të sjellë tek Komuna e Gjilanit:
  - 2.1.Raportin narrativ (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje) raportin financiar për mjetet e shpenzuara (shtojcë e bashkangjitur kësaj marrëveshjeje)
  - 2.2.Njofton Komunën e Gjilanit për çdo vonesë në realizimin e qëllimeve të subvencionimit

## **Neni 4**

1. Obligimet e Komunës së Gjilanit janë:
  - 1.1.Obligohet që shumën nga paragrafi 1 i nenit 2 të kësaj marrëveshje, t'ia transferoj në xhirlogarinë bankare të përfituesit, sipas kushteve të parapara me këtë marrëveshje;
  - 1.2.Bartja e mjeteve financiare do të bëhet në pajtim me rregullat financiare mbi pagesat.
2. Komuna e Gjilanit mbanë të drejtën e monitorimit/inspektimit dhe auditimit të realizimit të qëllimeve të subvencionimit, po që se paraqitet nevoja.

## Neni 5

### Afatet kohore

1. Afatet kohore të kësaj marrëveshje do të jenë obliguese për palët. Palët duhet të informojnë njëra tjetrën në rast të vonesave.
2. Kjo marrëveshje është e vlefshme pas datës së nënshkrimit nga palët.

## Neni 6

### Shkëputja e marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje mund të shkëputet në rast të:

- 1.1. Tejkalimit të pa justifikuar të afateve kohore të parapara me këtë marrëveshje;
- 1.2. Marrëveshjes me shkrim nga të dyja palët në marrëveshje;
- 1.3. Shpenzimit të mjeteve për qëllime tjera që nuk janë paraqitur me këtë marrëveshje dhe
- 1.4. Mos realizimit të subvencioneve për shkaqe objektive.

## Neni 7

### Kthimi i mjeteve

Në rast të rrethanave të ndryshme të cilat rezultojnë deri te mos realizimi i subvencioneve apo zvogëlojnë punën sipas vëllimit të paraparë me projekt, përfituesi është i obliguar t'i kthejë mjetet e pa shpenzuara tek Komuna e Gjilanit.

## Neni 8

### Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Çdo mosmarrëveshje eventuale lidhur me këtë marrëveshje, palët do ta zgjidhin vet, me synimin e përmirësimit dhe të realizimit të qëllimit të kësaj marrëveshje.

## Neni 9

### Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit të saj nga ana e dy palëve.

## Neni 10

Marrëveshja është përpiluar në 2 kopje të njëjta për secilën palë.

  
Komuna e Gjilanit  
Alban Hyseni, Kryetar

  
Nuhi Nuhiu